

There are no translations available.

## **SINDIKATA E PAVARUR E MINATORËVE TË SHQIPËRISË –SPMSH**

Presidenti i SPMSH pranë minatorëve të industrisë së bakrit për zgjidhjen e problemeve



Prej dy ditësh President i SPMSH-së z. Gëzim Kalaja, i shoqëruar nga stafi i tij z. Sami Kariqi dhe z. Jonuz Xhetani zv.Presidentë të SMPSH dhe avokatja e BSPSH-së znj. Arjola Alike , zhvilluan takime të rëndësishme me minatorët e Minierës së Bakrit të Lakut të Roshit , Fabrikës së Pasurimit në Fushë Arrëz dhe Minierës së Bakrit Munellë.

Në takimet e zhvilluara me punonjësit e industrisë minerare të Fushë Arrëzit morën pjesë dhe z. Gjon Zeka , Kryetar i BSP-së të Rrethit Pukë , Vlash Toplana , Vasil Ndoji , Gjovalin Vilapërkatësisht drejtuesit e Sindikatës së Rrethit Pukë dhe të Industrisë Minerare .

Në takim me minatorët u diskutuan probleme të rëndësishme dhe u informuan për situatën e krijuar pas vendimit të kompanisë për reduktimin e numrit të punëtorëve si rezultat i varfërimit të shtresës së mineralit.

SPMSH ka zhvilluar dy takime me përfaqësues të kompanisë BERALB Sh.a për zgjidhjen e problemeve të lindura dhe do të vazhdojë t'i japë rëndësi dialogut me kompaninë për realizimin e kërkesave të minatorëve dhe të punonjësve të Fabrikës së Pasurimit Fushë Arrëz.





Das një dialogu social të suksesshëm



Presidenti i SPMSH pranë minatorëve të industrisë së bakrit për zgjidhjen e problemeve



Presidenti i SPMSH pranë minatorëve të industrisë së bakrit për zgjidhjen e problemeve. SPMSH i kërkoi të bashkëpunojë me Ministrinë dhe Grupin për të bërë Akt-Marrëveshjen .